

## Shumëzimi i matricave. Matrica inverse

F. M. Berisha, N. Berisha



Universiteti i Prishtinës

## Qëllimet dhe objektivat

- Zgjidhja e një sistemi më tepër ekuacionesh lineare me metodën e eliminimit të Gauss-it.
- Zgjerimi i veprimeve me matrica me dy operacione të reja: prodhimi skalar dhe prodhimi matricor.
- Nxënja e nocioneve të matricës identike, matricës josingulare, matricës inverse dhe matricës së adjonguar.

# Përbajtja

- 1 Metoda e eliminimit e Gauss-it
- 2 Prodhimi skalar dhe prodhimi matricor
- 3 Matrica identike dhe matrica inverse

# Metoda e eliminimit e Gauss-it

## Shembull

Zgjidhni sistemin

$$\boxed{x_1} + x_2 + 3x_4 = 4$$

$$2x_1 + x_2 - x_3 + x_4 = 1$$

$$3x_1 - x_2 - x_3 + 2x_4 = -3$$

$$-x_1 + 2x_2 + 3x_3 - x_4 = 4$$

Zgjidhje....

Përshkruajmë ekuacionin **e parë**,  
shumëzojmë ekuacionin **e parë** me **2** dhe e zbresim nga **i dyti**,  
shumëzojmë **të parin** me **3** dhe e zbresim nga **i treti**,  
**i mbledhim** **të parin** ekuacionit **të katërtë**.



## Metoda e eliminimit e Gauss-it. (Vazhdim)

...Zgjidhje....

$$(E_2 - 2E_1) \rightarrow (E_2)$$

$$(E_3 - 3E_1) \rightarrow (E_3)$$

$$(E_4 + E_1) \rightarrow (E_4)$$

$$x_1 + x_2 + 3x_4 = 4$$

$$\boxed{-x_2} - x_3 - 5x_4 = -7$$

$$-4x_2 - x_3 - 7x_4 = -15$$

$$3x_2 + 3x_3 + 2x_4 = 8.$$



## Metoda e eliminimit e Gauss-it. (Vazhdim)

...Zgjidhje....

$$(E_3 - 4E_2) \rightarrow (E_3)$$

$$(E_4 + 3E_2) \rightarrow (E_4)$$

$$\begin{aligned}x_1 + x_2 &+ 3x_4 = 4 \\-x_2 - x_3 - 5x_4 &= -7 \\+ 3x_3 + 13x_4 &= 13 \\- 13x_4 &= -13.\end{aligned}$$



## Metoda e eliminimit e Gauss-it. (Vazhdim)

...Zgjidhje.

Sistemin e fundit mund ta zgjidhim *me zëvendësim nga prapa*:

$$x_4 = \frac{-13}{-13} = 1$$

$$x_3 = \frac{13 - 13x_4}{3} = \frac{1}{3}(13 - 13 \cdot 1) = 0$$

$$x_2 = -(-7 + 5x_4 + x_3) = -(-7 + 5 \cdot 1 + 0) = 2$$

$$x_1 = 4 - 3x_4 - x_2 = 4 - 3 - 2 = -1.$$



# Metoda e eliminimit e Gauss-it. (Vazhdim)

## Mbani mend!

Edhe më lehtë, pa i shënuar fare ndryshoret e ekuacioneve, metodën do të mund ta zbatonim duke e aplikuar në *matricën e zgjeruar të sistemit*, e cila përbëhet nga matrica e koeficientëve të sistemit, të cilës i përshkruhet nga e djathta shtylla e lirë. Pastaj veprimet kryhen mbi elementët e kësaj matrice.

# Prodhimi skalar

## Prodhimi me një skalar

Në qoftë se  $k$  është një numër (ose, *skalar*), atëherë *prodhimi skalar* i skalarit  $k$  me një matricë  $A$  është matrica  $B$  e rendit të njëjtë sikur  $A$ , elementet e së cilës janë të barabartë me prodhimin e elementeve përkatës të  $A$  me  $k$ ; pra,  $B = kA = [b_{ij}]$ , ku  $b_{ij} = k \cdot a_{ij}$ .

# Prodhimi skalar. (Vazhdim)

## Shembull

Shumëzoni skalarisht matricën

$$A = \begin{bmatrix} -1 & 2 \\ 3 & -4 \end{bmatrix}$$

me numrin 5.

Zgjidhje....


$$kA = 5 \cdot \begin{bmatrix} -1 & 2 \\ 3 & -4 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} 5 \cdot (-1) & 5 \cdot 2 \\ 5 \cdot 3 & 5 \cdot (-4) \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} -5 & 10 \\ 15 & -20 \end{bmatrix}.$$



## Prodhimi matricor

Në qoftë se matrica  $A$  është e rendit  $m \times p$ ,  
kurse matrica  $B$  e rendit  $p \times n$ ,  
atëherë prodhimi  $A \cdot B$  do të jetë matricë e rendit  $m \times n$

Tregon se  $A$  mund të shumëzohet me  $B$



Tregon dimensionin e prodhimit  $A \cdot B$

# Prodhimi matricor. (Vazhdim)

## Prodhimi matricor

Në qoftë se  $A$  është një matricë e rendit  $m \times p$  dhe  $B$  është një matricë e rendit  $p \times n$ , atëherë *prodhimi matricor* i matricës  $A$  me  $B$  është matrica  $C$  e rendit  $m \times n$ , elementet e së cilës janë të barabarta me shumën e prodhimeve të elementeve të një rreshti të  $A$  me elementet përkatëse të një shtylle të  $B$ ; pra,  $C = AB = [c_{ij}]$ , ku

$$c_{ij} = a_{i1}b_{1j} + a_{i2}b_{2j} + \cdots + a_{ip}b_{pj} = \sum_{k=1}^p a_{ik}b_{kj}.$$

## Prodhimi matricor. (Vazhdim)

### Shembull

Le të jenë

$$A = \begin{bmatrix} 2 & 1 & -1 \\ 3 & 1 & 2 \\ 0 & -2 & -3 \end{bmatrix}, \quad B = \begin{bmatrix} 1 & -1 & 1 \\ 2 & -1 & 2 \\ 3 & 0 & -3 \end{bmatrix}.$$

Llogaritni prodhimin  $AB$ .

## Prodhimi matricor. (Vazhdim)

Zgjidhje.

Meqë dimensionet e matricave  $A$  e  $B$  janë  $3 \times 3$  dhe  $3 \times 3$ , atëherë është i mundur prodhimi  $AB$ , dhe rezultati do të jetë matricë  $3 \times 3$ :

$$AB = \begin{bmatrix} 2 & 1 & -1 \\ 3 & 1 & 2 \\ 0 & -2 & -3 \end{bmatrix} \cdot \begin{bmatrix} 1 & -1 & 1 \\ 2 & -1 & 2 \\ 3 & 0 & 3 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} 1 & -3 & 1 \\ 11 & -4 & 11 \\ -13 & 2 & -13 \end{bmatrix}.$$



# Matrica identike

## Matricë identike

*Matricë identike* / është një matricë katrore e cila i ka të gjitha elementet e diagonales të barabartë me 1, kurse të gjithë elementet tjerë të barabartë me 0.

## Shembuj matricash identike

### Shembull

$$\begin{bmatrix} 1 & 0 \\ 0 & 1 \end{bmatrix}, \quad \begin{bmatrix} 1 & 0 & 0 \\ 0 & 1 & 0 \\ 0 & 0 & 1 \end{bmatrix}, \quad \begin{bmatrix} 1 & 0 & 0 & 0 \\ 0 & 1 & 0 & 0 \\ 0 & 0 & 1 & 0 \\ 0 & 0 & 0 & 1 \end{bmatrix}.$$

# Matrica identike. (Vazhdim)

## Shembull

Gjeni prodhimin e një matrice katrore të rendit 2

$$A = \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} \\ a_{21} & a_{22} \end{bmatrix}$$

me matricën identike / të rendit  $2 \times 2$ . Gjeni pastaj prodhimit /  $A$ .

## Matrica identike. (Vazhdim)

Zgjidhje.

$$AI = \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} \\ a_{21} & a_{22} \end{bmatrix} \cdot \begin{bmatrix} 1 & 0 \\ 0 & 1 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} a_{11} \cdot 1 + a_{12} \cdot 0 & a_{11} \cdot 0 + a_{12} \cdot 1 \\ a_{21} \cdot 1 + a_{22} \cdot 0 & a_{21} \cdot 0 + a_{22} \cdot 1 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} \\ a_{21} & a_{22} \end{bmatrix} = A.$$

$$IA = \begin{bmatrix} 1 & 0 \\ 0 & 1 \end{bmatrix} \cdot \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} \\ a_{21} & a_{22} \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} 1 \cdot a_{11} + 0 \cdot a_{21} & 1 \cdot a_{12} + 0 \cdot a_{22} \\ 0 \cdot a_{11} + 1 \cdot a_{21} & 0 \cdot a_{12} + 1 \cdot a_{22} \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} \\ a_{21} & a_{22} \end{bmatrix} = A.$$



## Matrica identike. (Vazhdim)

### Vetia e matricave identike

Mund t<sup>e</sup> vërtetohet se p<sup>r</sup> çdo matricë  $A$  dhe matricë identike  $I$  p<sup>r</sup> t<sup>e</sup> cilën ekziston prodhimi  $AI$  ose  $IA$  vlen

$$AI = A \quad \text{and} \quad IA = A.$$

# Matrica inverse

## Matrica inverse

- Për matricë katrore  $A$  të rendit  $n$  themi se është *josingulare* në qoftë se  $\det A \neq 0$ .
- Në qoftë se  $A$  është një matricë josingulare, atëherë *matrica inverse* e  $A$ , e shënojmë me  $A^{-1}$ , quhet matrica e tillë që

$$A \cdot A^{-1} = A^{-1} \cdot A = I.$$

# Matrica inverse. (Vazhdim)

## Matrica inverse

Në qoftë se  $A$  është një matricë josingulare,  
atëherë matrica e saj inverse  $A^{-1}$  është

$$A^{-1} = \frac{1}{\det A} \cdot \text{adj } A,$$

ku  $\text{adj } A$  është *matrica e adjonguar* e matricës  $A$ ,  
e cila përbëhet nga kofaktorët sipas rreshtave të elementeve të  $A$   
të rradhitur sipas shtyllave:

$$\text{adj } A = \begin{bmatrix} \alpha_{11} & \alpha_{21} & \alpha_{31} & \dots & \alpha_{n1} \\ \alpha_{12} & \alpha_{22} & \alpha_{32} & \dots & \alpha_{n2} \\ \alpha_{13} & \alpha_{23} & \alpha_{33} & \dots & \alpha_{n3} \\ \vdots & \vdots & \vdots & & \vdots \\ \alpha_{1n} & \alpha_{2n} & \alpha_{3n} & \dots & \alpha_{nn} \end{bmatrix}.$$

# Matrica inverse. (Vazhdim)

Sistemi i ekuacioneve lineare në trjatë matricore...

Sistemi i ekucacioneve lineare

$$a_{11}x_1 + a_{12}x_2 + a_{13}x_3 + \cdots + a_{1n}x_n = b_1$$

$$a_{21}x_1 + a_{22}x_2 + a_{23}x_3 + \cdots + a_{2n}x_n = b_2$$

⋮

$$a_{n1}x_1 + a_{n2}x_2 + a_{n3}x_3 + \cdots + a_{nn}x_n = b_n,$$

mund të shkruhet si barazim matricor

$$AX = B,$$

ku  $A$  është matrica e sistemit,  $X$  është shtylla e të panjohurave, kurse  $B$  është shtylla e lirë;

## Matrica inverse. (Vazhdim)

...Sistemi i ekuacioneve lineare në trjatë matricore

d.m.th.

$$A = \begin{bmatrix} a_{11} & a_{12} & a_{13} & \dots & a_{1n} \\ a_{21} & a_{22} & a_{23} & \dots & a_{2n} \\ \vdots & \vdots & \vdots & & \vdots \\ a_{n1} & a_{n2} & a_{n3} & \dots & a_{nn} \end{bmatrix},$$

$$X = \begin{bmatrix} x_1 \\ x_2 \\ \vdots \\ x_n \end{bmatrix}, \quad B = \begin{bmatrix} b_1 \\ b_2 \\ \vdots \\ b_n \end{bmatrix}.$$

## Matrica inverse. (Vazhdim)

Zgjidhja e një sistemi me anë të matricës inverse

$$X = A^{-1}B$$

është zgjidhja e ekuacionit matricor të sistemit.

Vërtet,

$$AX = A(A^{-1}B) = (AA^{-1})B = IB = B.$$

# Matrica inverse. (Vazhdim)

Mbani mend!

- Llogaritja e matricës inverse kërkon numër të madh veprimesh, prandaj është e papërshtatshme për t'u zbatuar në praktikë.
- Në rastin e përgjithshëm, metoda më e përshtatshme për zgjidhjen e një sistemi ekuacionesh lineare është metoda e Gauss-it.

## Udhëzime për lexim të mëtejshmë

- <http://www.fberisha.org>
- **Detyrë shtëpie:** Detyrat për ushtrime nga materiali mësimor.
- F. M. Berisha, M. Q. Berisha, *Matematikë – për biznes dhe ekonomiks*, fq. 28–40.

## Përfundim

- Teknika e zgjidhjes së një sistemi ekuacionesh lineare me metodën e Gauss-it
- Llogaritja e prodhimit të një matrice me një skalar dhe me një matricë
- Kuptimi i lidhmërisë ndërmjet një sistemi ekuacionesh lineare dhe ekuacionit matricor të tij